

V E N D I M
Nr.498, datë 5.8.1996

**PËR NDRYSHIMIN E TARIFAVE TË TRANSPORTIT TË UDHËTARËVE DHE RRITJEN
E SUBVENCIONEVE**

Në mbështetje të neneve 2, 4 dhe 5 të ligjit nr.7581, datë 7.7.1992, me propozimin e Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Industrisë, Transportit dhe Tregtisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Tarifat e transportit të udhëtarëve, të caktuara në pikën 1, shkronjat “a” dhe “b” të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.598, datë 20.12.1994 “Për ndryshimin e tarifave të transportit të udhëtarëve”, ndryshohen si vijon:

a) Tarifat e transportit qytetar të udhëtarëve në linjat me largësi deri në 9 km, të miratuara sipas neneve 15 dhe 16 të urdhëresës nr.7, datë 17.8.1993 “Për transportin rrugor publik të udhëtarëve dhe bagazheve”, caktohen: 10 lekë për udhëtarë për një vajtje ose kthim, 250 lekë për një biletë pajtimi mujor për qytetarët dhe 120 lekë për një biletë pajtimi mujore për nxënësit dhe studentët. Në këto tarifa është përfshirë edhe TVSH.

b) Tarifat e transportit hekurudhor të udhëtarëve sipas zonave rriten 25 deri 30 për qind, duke përfshirë edhe TVSH.

2. Ngarkohen Ministria e Industrisë, Transportit dhe Tregtisë dhe Ministria e Financave të përcaktojnë me udhëzim të veçantë çmimet e reja të biletave sipas zonave të transportit hekurudhor si kufi maksimal.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 shtator 1996.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi